



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ Datë ____/____/2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028 NË
BASHKINË DURRËS**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2018 “Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 9936/ 2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr. 68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 9632/ 2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komunitete Fetare, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe,

TË VENDOSË :

1. Miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Durrës, bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komunitete Fetare, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE
Drejtor

Alceida Rroshi

**DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS
RINISË, SPORTIT DHE KOMUNITETE FETARE**
Drejtor
Adrian Gurra

KRYETARI I BASHKISË

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA ARSIM, KULTURËS, RINISË, SPORTEVE DHE KOMUNITETEVE FETARE
SEKTORI I ARSIMIT

RELACION

PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028” NË
BASHKINË Durrës

Të nderuar Këshilltarë,

Plani i Arsimit Parauniversitar 2026–2028 për Bashkinë Durrës është një dokument strategjik i domosdoshëm që synon të orientojë zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në territorin e bashkisë për tre vitet e ardhshme. Hartimi i tij është rezultat i një analize të thelluar të situatës aktuale, tendencave demografike, nevojave komunitare dhe sfidave ekzistuese në arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky dokument është një instrument thelbësor planifikimi për strukturat vendimmarrëse dhe administrative për të garantuar një arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Durrës.

Kuadri Ligjor dhe Institucional

Plani mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor kombëtar, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligjet dhe udhëzimet përkatëse për menaxhimin financiar, mbrojtjen e fëmijëve dhe gjithëpërfshirjen në arsim. Në bazë të këtyre akteve, Bashkia Durrës ka detyrimin dhe përgjegjësinë për të hartuar politika zhvillimore në fushën e arsimit dhe për të siguruar infrastrukturë, staf të kualifikuar dhe shërbime të barabarta për të gjithë. Gjithashtu, për referencë janë marrë në konsideratë dhe në shqyrtim edhe baza ligjore si më poshtë:

- **Ligji Nr. 9936/ 2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/ 2017** “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/ 2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së Vlerësimit të Cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve**, 2021–2025
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-social dhe përfshirja sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

Analiza e Situatës Aktuale

Plani ofron një analizë të detajuar për të gjithë Bashkinë Durrës në lidhje me arsimin parauniversitar. Në total, në këtë bashki funksionojnë 70 kopshte nga të cilat (55 publike dhe 15 jopublike), 57 shkolla 9-vjeçare nga të cilat (41 publike dhe 16 jopublike), 30 shkolla të mesme nga të cilat (15 publike dhe 15 jopublike), 3 shkolla profesionale nga të cilat (2 publike dhe 1 jopublike) si dhe 2 konvikte publike. Gjithsej në vitin 2025 bashkia menaxhon 491 punonjës që i takojnë sistemit parauniversitar të arsimit, nga këto 233 edukativ dhe 258 punonjës ndihmës. Në raport me fëmijët e lindur 3-6 vjeç në Bashkinë Durrës fëmijët që frekuentojnë arsimin parashkollor janë rreth 75% e fëmijëve të kësaj moshe, dhe fëmijë që ende mbeten jashtë sistemit janë rreth 25%. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Durrës. Bashkia menaxhon 86 godina arsimore dhe 81.3% e tyre që nga delegimi i funksionit janë ndërtuar të reja ose janë rikonstruktuar, si dhe 18.7% e godinave arsimore kanë nevojë për rikonstrukcion ose zgjerim për shkak të mbingarkesës ose infrastrukturës së amortizuar. Gjithashtu vlen të theksohet se përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore ka luajtur rol dhe në shtimin e shkollave qendra komunitare që tani në Bashkinë Durrës janë 27 shkolla nga të cilat 9 vjeçare 19 shkolla dhe të mesme 8 shkolla.

Vizioni dhe Objektivat Strategjike

Vizioni i planit është të garantojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Durrës,

Objektivat strategjike përfshijnë:

- Rritja e aksesit në arsimin parauniversitar për të gjithë fëmijët e Bashkisë Durrës, me fokus në zonat më të pafavorizuara dhe grupet vulnerabël.
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies
- Forcimi i kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për të siguruar një menaxhim efikas dhe inovativ.
- Mbështetjen për fëmijët me aftësi ndryshe dhe nga grupe të marginalizuara,
- Forcimin e rolit të shkollës si qendër komunitare.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Durrës është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Durrës dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parauniversitar.

Konkretisht nëpërmjet planit synohet të realizohet :

- Zgjerimi i rrjetit të çerdheve dhe kopshteve për të përfshirë më shumë fëmijë në arsimin parashkollor.
- Masa për parandalimin e braktisjes shkollore në zonat periferike dhe komunitetet vulnerabël.
- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit në metodologji bashkëkohore dhe përdorim të teknologjisë.
- Pajisja e shkollave me laboratorë, mjete didaktike moderne dhe lidhje të qëndrueshme me internet.
- Parashikimi i fondeve në buxhetin vendor për programe trajnuese dhe certifikime të stafit mësimor e ndihmës.
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira.

Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin e Bashkisë Durrës është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Investimet Kapitale të Planifikuara

Plani i investimeve kapitale i Bashkisë Durrës për arsimin parauniversitar për periudhën 2026–2028 është ndërtuar mbi objektivin e përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese, ndërtimit të godinave të reja, pajisjes së institucioneve arsimore me orendi dhe logjistikë moderne, si dhe garantimit të kushteve të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë në procesin edukativ. Në tërësi, Bashkia Durrës ka planifikuar një fond prej **4.648 milion lekësh (ose 4.6 miliard lekë)** për investime kapitale në arsimin parauniversitar gjatë viteve 2026–2028. Të gjitha projektet e planifikuara do të financohen nga buxheti vendor i bashkisë. Këto ndërhyrje përfaqësojnë një angazhim të qartë për modernizimin e infrastrukturës arsimore, rritjen e aksesit dhe përmirësimin e kushteve të të nxënit, si për fëmijët e

ciklit parashkollor dhe bazë, ashtu edhe për të rinjtë që ndjekin arsimin e mesëm dhe profesional. Ky plan përbën një hap të rëndësishëm drejt garantimit të një sistemi arsimor më gjithëpërfshirës, cilësor dhe të orientuar drejt të ardhmes.

Investimet në arsimin bazë dhe parashkollor

Pjesa më e madhe e investimeve është përqendruar në ciklin e arsimit bazë (përfshirë edhe arsimin parashkollor). Këtu përfshihen projekte të rëndësishme si ndërtimi i shkollave të reja dhe rikonstruksioni i atyre ekzistuese. Konkretisht, planifikohet ndërtimi i shkollave 9-vjeçare “Met Hasa”, “Vadardh” në Sukth, si dhe shkolla e re 9 vjeçare në Bishtkamëz. Këto investime kapin një shumë të konsiderueshme që do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe sigurisë së mjediseve shkollore. Një tjetër projekt madhor është rikonstruksioni i shkollës “Bajram Curri”, si dhe një fond i dedikuar prej 800 milionë lekësh për rikonstruksione të tjera të shkollave 9-vjeçare në vitin 2028. Po ashtu, në plan është parashikuar ndërtimi i një godine të re që do të bashkojë dy shkolla ekzistuese: “Nënë Tereza” dhe “Vasil Ziu”, me një kosto totale prej afro 1.5 miliard lekësh. Përveç godinave, parashikohet edhe furnizimi i kopshteve me orëndi dhe pajisje të reja, duke përfshirë kondicionerë, orëndi e pajisje për kopshte e shkolla, paisje kuzhine etj., ç’ka synon të përmirësojë ndjeshëm komoditetin dhe funksionalitetin e ambienteve për fëmijët dhe edukatorët. Totali i investimeve për këtë segment për periudhën 2026–2028 është 3.417 milion lekë, të ndara në mënyrë progresive në tre vitet respektive: 371.9 milion lekë në 2026, 559.5 milion lekë në 2027 dhe 400 milion lekë në 2028.

Investimet në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe profesional

Plani për arsimin e mesëm përfshin ndërtimin e gjimnazit të ri në njësinë administrative Manëz, si dhe pajisjen me orëndi e mjete të tjera mësimore. Një tjetër komponent i rëndësishëm është furnizimi me pajisje kuzhine dhe lavanderie për konviktet, duke përmirësuar ndjeshëm jetesën e nxënësve rezidentë. Deri në vitin 2028, është parashikuar ndërtimi i shkolles së mesme “Gjergj Kastrioti”, me një fond total prej 670 milion lekësh. Me këtë ndërhyrje synohet të përfundohet ndërhyrja në infrastrukturë për arsimin e mesëm e konviktet dhe realizimin e objektivit buxhetor për përfundimin e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksionin e tyre brenda vitit 2028. Totali i investimeve në arsimin e mesëm për periudhën 2026–2028 është 1.231 milion lekë, ku pjesa më e madhe e financimit parashikohet për vitin 2028.

Buxheti dhe Burimet Financiare

Financimi i planit do të sigurohet përmes të ardhurave vendore, transfertave nga buxheti i shtetit dhe projekteve të bashkëpunimit. Janë përcaktuar nevojat buxhetore vjetore për secilën masë ndërhyrjeje, si dhe është hartuar një planifikim afatmesëm buxhetor për të mbështetur realizimin e objektivave. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit të infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje në arsimin parashkollor të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;

- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimet për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë konviktet publike.

Në këtë plan është përfshirë listëa e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë lekë) e cila përfshin projektet që do të financohen nga Buxheti i Bashkisë Durrës gjatë kësaj periudhe., bashkëlidhur.

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë zbatimi e monitorimi, vlerësimi të progresit si dhe raportim e transparence te pershkuara si me poshte:

Mekanizmat e Zbatimit dhe Monitorimit

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjike. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

- Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteve të planifikuara
- Vlerësimi i ndikimit të aktiviteve në komunitetin arsimor

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Durrës. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

Rekomandim për Miratim

Duke pasur parasysh rëndësinë strategjike të këtij dokumenti dhe bazuar në kuadrin ligjor dhe nevojën për ndërhyrje sistematike në arsimin parauniversitar, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve e Komuniteteve Fetare në Bashkinë e Durrësit, nëpërmjet këtij relacioni, kërkon miratimin nga Komisioni i Arsimit dhe dërgimin për votim në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të Durrësit.

Duke ju falenderuar,

Për Sektorin e Arsimit

Përgjegjëse

Nikoleta Rusha



**Për Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë,
Sporteve e Komuniteteve Fetare**

Drejtor

Adrian Gurra




Tabela 1 Plani I investimeve Kapitale: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor, në mijë lekë

Emërtimi i Projektit	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kosto totale	2025	2026	2027	2028	Totali i planit të investimeve kapitale sipas projekteve
Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa" (1071702)	12/5/2024	3/5/2026	229,730	114,366	60,251	-	-	404,347
Mbikqyrje e objektit : Ndërtim shkolla 9 vjeçare Met Hasa	5/1/2024	7/5/2025	2,756	2,107	42	-	-	4,905
Kolaudim objekti : Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa"	5/25/2024	5/23/2025	365	-	365	-	-	730
Ndërtim shkolla 9 vjeçare Vadardh Sukth 1071705	9/18/2024	12/28/2026	260,525	197,000	63,525	-	-	521,050
Mbikqyrje objekti : Ndërtim I ri shkolla 9 vjeçare Vadardh. Njësia Administrative Sukth	12/25/2024	9/1/2026	3,140	1,939	611	-	-	5,690
Kolaudim objekti : Ndërtim i ri shkolla 9 vjeçare Vadardh.Njësia Administrative Sukth	12/18/2024	12/28/2026	382	-	382	-	-	764
Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare "Bajram Curri" (1071827)	10/1/2025	8/1/2026	48,000	27,292	20,708	-	-	96,000
Mbikqyrje objekti : Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare Bajram Curri (1071828)	11/1/2025	8/1/2026	832	21	811	-	-	1,664
Kolaudim objekti : Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare Bajram Curri (1071829)	7/1/2026	8/1/2026	81	-	81	-	-	162
FV orendi pajisje për kopshtet (1071830)	2/1/2025	7/1/2025	2,100	2,100	-	-	-	4,200
FV kondicioner për kopshtet (1071831)	2/1/2025	7/1/2025	4,300	4,300	-	-	-	8,600
FV Orendi e Pajisje shkolla 9 vjeçare Vadardhë	2/1/2026	4/1/2026	9,100	-	9,100	-	-	18,200
Ndërtim i ri shkolla 9 vjeçare Bishtkamëz	2/1/2026	8/10/2026	35,500	-	35,500	-	-	71,000
Mbikqyrje objekti: Ndërtim i ri shkolla 9 vjeçare Bishtkamëz	2/1/2026	8/10/2026	540	-	540	-	-	1,080
Kolaudim objekti: Ndërtim i ri shkolla 9 vjeçare Bishtkamëz	8/10/2026	9/10/2026	64	-	64	-	-	128
Rikonstrukcion i shkollave 9 vjeçare	1/5/2028	12/31/2028	400,000	-	-	-	400,000	800,000
Ndërtim godinë e re për 2 shkollat Nënë Tereza dhe Vasil Ziu (1071708)	1/5/2027	12/31/2027	739,534	-	180,000	559,534	-	1,479,068
Totali planit të investimeve kapitale sipas viteve			1,736,949	349,125	371,980	559,534	400,000	3,417,588

Tabela 2 Plani I investimeve kapitale: Arsimi i mesëm I përgjithshëm

Emërtimi i Projektit	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kosto totale	2025	2026	2027	2028	Totali i planit të investimeve kapitale sipas projekteve
Ndërtim i ri gjimnazi Manëz, Njësia Administrative Manëz 1071713)	11/1/2024	2/5/2026	315,163	119,703	94,542	-	-	529,408
Mbikqyrje objekti : Ndërtim i ri gjimnazi Manëz, Njësia Administrative Manëz 1071714	11/1/2024	2/5/2026	3,222	1,030	1,143	-	-	5,395
Kolaudim objekti : Ndërtim i ri gjimnazi Manëz, Njësia Administrative Manëz 1071715	1/1/2026	2/5/2026	507	-	507	-	-	1,014
FV pajisje kuzhine dhe lavanterie për konviktet (1071832)	3/1/2025	12/31/2025	6,400	6,400	-	-	-	12,800
Orendi e pajisje gjimnazi "Manëz"	2/1/2026	4/1/2026	6,200	-	6,200	-	-	12,400
Ndërtim i ri shkolla e mesme "Gjergj Kastrioti"	1/5/2028	12/31/2028	335,000	-	-	-	335,000	670,000
Totali planit të investimeve kapitale sipas viteve			666,492	127,133	102,392	-	335,000	1,231,017